



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 527/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë, paraqitur kundër Rafet Ibishi, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë.

Arsyetim

Me datën 04.11.2013, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendohet se më datë 03.11.2013 në qendrën e votimit nr. 1113B në shkollën fillore “Trepça” pretendohet se kryetari i shoqatës së veteranëve të luftës së UÇK Rafet Ibishi ka bërë presion tek votuesit për ta votuar PDK-në me qëllim të deformoj rezultatin e votimit pretendohet në ankesë. Veprimi i tillë është në kundërshtim me Kodin Penal të Kosovës, dhe neni 213, thuhet në pretendimet e ankuesit..

Në mbështetje të pretendimeve parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë, përveç, se ka siguruar numrin e telefonit të Musa Ajeti në rolin e dëshmitarit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: *“Mund te apelohe vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”.*

PZAP-i konstatoi se pretendimet e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) nuk qëndrojnë ngase në shkresat e lëndës nuk ka bashkangjitur asnjë provë bindëse që mund të vërtetohet shkelja e supozuar.

Andaj në kuptim të nenin 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 527/2013 më datën 07.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.